

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ferit Osmani, kryetar i kolegjit, gjyqtarët Hashim Çollaku dhe Rasim Rasimi, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Hysni Ismaili, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit L.K. nga Gjakova, Rr. “...” nr...., për shkak të dy veprave penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par 3 lidhur me par 1 pika 1.4 të KPK, duke vendosur sipas ankesës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë, P.nr.621/2016, të datës 28.02.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur me 30.05.2017, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

Refuzohet si e pa bazuar, ankesa e Prokurorisë Themelore në Gjakovë, kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë, P.nr.621/2016, të datës 28.02.2017, **vërtetohet.**

**A r s y e t i m**

Me aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës Themelore në Gjakovë, P.nr.621/2016, të datës 28.02.2017, është shpallur fajtor i akuzuari L.K. për shkak të dy veprave penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par 3 lidhur me par 1 pika 1.4 të KPK, dhe për secilën vepër penale i është shqiptuar dënimi me kusht, duke i vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej nga 3 (tre) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet po që se i akuzuari në afatin e verifikimit prej nga 2 (dy) viteve, nuk kryen vepër të re penale. Në kuptim të nenit 80 par 1 lidhur me par 2 pika 2.2 të KPK, të akuzuarit i shqiptohet dënimi me kusht unik, me të cilin dënim i vërtetohet dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 5 (pesë) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet po që se i akuzuari në afatin e verifikimit prej 2 (dy) viteve, nuk kryen ndonjë vepër të re penale.

Të dëmtuarat A dhe M.K., për realizimin e kërkesës pasurore juridike janë udhëzuar në kontestin e rregullt civilo-juridik.

Shpenzimet e procedurës penale kanë rënë në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

Kundër këtij aktgjykimi, në afat ligjor ka ushtruar ankesë Prokuroria Themelore në Gjakovë, për shkak të shkeljeve të ligjit penal, si dhe vendimit për dënimin, duke propozuar që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet, dhe të akuzuarit ti shqiptohet dënimi me burgim efektiv.

Prokuroria e Apelit në Prishtinë me shkresën PPA/II.nr.531/2017, të datës 05.05.2017, duke u sqaruar përkritazi me ankesën e prokurorisë, ka propozuar që e njëjta të aprovohet si e bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të akuzuarit ti shqiptohet dënimi me burgim efektiv.

Gjykata e Apelit në kuptim të nenit 394 të KPPK, duke vlerësuar pretendimet ankimore nga ankesa prokurorisë, propozimit me shkrim të Prokurorisë së Apelit në Prishtinë, si dhe shkresave tjera të lëndës ka gjetur se:

### **Ankesa Prokurorisë Themelore në Gjakovë, nuk është e bazuar.**

Me qenë se aktgjykimi i shkallës së parë nuk është ankimuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, gjykata duke vepruar në pajtim me nenin 394 të KPPK, e shqyrtoj aktgjykimin e ankimuar nëse i njëjti është marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe gjeti se i njëjti nuk përmban shkelje të dispozitave të procedurës, të cilat do të kushtëzonin anulimin e tij, për të cilat kjo gjykatë kujdeset kryesisht sipas detyrës zyrtare.

Sipas ankesës së prokurorisë aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, ankimohet për shkak të shkeljeve të ligjit penal, mirëpo nuk jepet ndonjë arsye përkritazi me pretendimet ankimore, mirëpo kolegji i kësaj gjykate sipas detyrës zyrtare e ka vlerësuar ankesën, aktgjykimin e ankimuar si dhe shkresat e tjera të lëndës dhe ka ardhur në përfundim se aktgjykimi i ankimuar nuk përfshihet me shkeljet e ligjit penal të parapara me nenin 385 të KPK, se veprat penale për të cilat është akuzuar i akuzuari, janë të parapara në Kodin Penal, dhe si të tilla paraqesin vepër penale, se nuk ekzistojnë rrethana që e përjashtojnë të akuzuarin nga përgjegjësia penale dhe ndjekja penale, se gjykata e shkallës së parë ka zbatuar ligjin që është i aplikueshëm në kohën e kryerjes së veprës penale, se ka vepruar në kuadër të kompetencës ligjore, ashtu që aktgjykimi është i pranueshëm për kolegjin e kësaj gjykate.

Sipas ankesës së prokurorisë, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është ankimuar për shkak vendimit për dënimin, duke theksuar se gjykata e shkallës së parë, drejtë ka vendosur kur të akuzuarin L.K. e ka shpallur fajtor për shkak të veprave penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par 3 lidhur me par 1 pika 1.4 të KPK, mirëpo dënimi i shqiptuar të akuzuarit, është shumë i butë dhe nuk është proporcional me peshën e veprave penale të kryera, përkundër asaj që i akuzuari e ka pranuar fajësinë për veprat penale, se është i martuar, baba i tre fëmijëve, i gjendjes së varfër ekonomike, shfrytëzues i ndihmave sociale, se është penduar dhe ka shprehur keqardhje për rastin e ndodhur, se ka patur sjellje korrekte në gjykatë, mirëpo në këtë çështje penale sikur mos të kishte fare rrethana rënduese, të cilave gjykata është dashur që tu kushtojë rëndësi, e sidomos të ketë parasysh intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur, kurse në rastin konkret kemi të bëjmë me vepra penale nga të cilat është dëmtuar vajza, si dhe bashkëshortja nga ana e të akuzuarit, të cilat kanë marrë lëndime trupore sikurse janë përshkruar në pikat e dispozitivit të aktgjykimit, andaj, jemi të bindur se me dënim të shqiptuar të këtillë nuk mund të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimit i paraparë me ligj.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, ka vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, ankesën e ushtruar nga prokuroria, si dhe shkresat e tjera të lëndës, dhe ka ardhur në

përfundim, se nga ana e gjykatës së shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të plotë është vërtetuar gjendja faktike, se aktgjykimi i ankimuar nuk përfshihet me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, si dhe shkeljet e ligjit penal, andaj, duke vlerësuar aktgjykimin e ankimuar, kolegji vie në përfundim se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë me rastin e marrjes së vendimit për dënimin, caktimit të llojit dhe lartësisë së tij, në kuptim të nenit 73 të KPK, sikurse janë rrethanat lehtësuese, se i akuzuari e ka pranuar fajësinë për veprat penale të cilat i vihen në barrë, se është penduar thellësisht dhe ka shprehur keqardhje për veprimet e kryera, se është i martuar, baba i tre fëmijëve, se ka patur sjellje korrekte në gjykatë, se është shfrytëzues i ndihmave sociale, ka vlerësuar edhe rrethanat rënduese sikurse është mënyra e kryerjes së veprave penale, si dhe natyrën e të njëjtave, andaj, në prani të këtyre rrethanave, duke mos gjetur ndonjë rrethanë posaçërisht rënduese, kolegji i kësaj gjykate, është i bindur se me dënimin e shqiptuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij i paraparë me nenin 41 të KPK, që të parandaloj kryerësin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëj rehabilitimin e tij, të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëj kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale, dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Nga sa u tha më lartë e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPPK, u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
**PA1. nr.510/2017 të datës 30.05.2017**

**Bashkëpunëtori profesional**  
**Hysni Ismaili**

**Anëtarët e kolegjit**  
**Hashim Çollaku**

**Kryetari i kolegjit**  
**Ferit Osmani**

**Rasim Rasimi**